



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	17.06.2021
Referenc-ë:	07-353/04-103316/21
Për/ Za/ To:	Youth Initiative for Human Rights
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-103316/21 nga Youth Initiative for Human Rights me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” deri tek Katedralja si dhe pllatoja afër Hotel Grand. Me rastin e shënimit të Ditës së Krenarisë apo ndryshe “Parada e Krenarisë” është paraparë të mbahet aktivitet me datë 1 Korrik 2021.

Gjatë aktivitetit është paraparë të jenë prezent dy kamion njëri do të jetë statik në sheshin “Skënderbeu” për shpërndarjen e pijeve jo aloolike tjetri ta udhëheqsh paradë me muzikë nga sheshi “Skënderbeu” deri tek Katedralja për tu kthyer tek pllatoja afër Hotel Grandit.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 1 Korrik 2021 si dhe lejohet hyrja e kamionit në sheshin “Skënderbeu” vetëm të qëndroj statik për shpërndarjen e pijeve jo aloolike ndërsa lëvizja e kamionit tjetër nga sheshi “Skënderbeu” deri tek “Katedralja” është e ndaluar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Për të njëjtin aktivitet të lajmërohet Policia e Kosovës;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.